



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova – Republic of Kosovo**  
**ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT**  
**TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE**  
**PROCUREMENT REVIEW BODY**



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë  
Tel: 383 38 312 309 email: [oshp@rks-gov.net](mailto:oshp@rks-gov.net)

**OSHP: 2026/0179**

**OSHP: 2026/0180**

Paneli Shqyrtues, i emëruar në bazë të nenit 105, 106, dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Republikës së Kosovës (Ligji nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/L-068, i plotësuar dhe Ligjin 05/L-092) në përbërjen nga Isa Hasani, panelist individual, duke vendosur sipas ankesës së OE "ALL STONE" SH.P.K. dhe OE "Company Murseli" SH.P.K., kundër Vendimit për anulimin e procedurës së prokurimit, lidhur me aktivitetin e prokurimit "MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA" me numër të prokurimit; 214/30400-25-11613-2-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS, më 21.04.2026, mori këtë:

### **Vendim**

1. Refuzohen si të e pabazuara, ankesa OE" ALL STONE "SH.P.K., me nr. 2026/0179, e datës 23.03.2026 dhe ankesa OE" Company Murseli "SH.P.K., me nr. 2026/0180, e datës 23.03.2026, lidhur me aktivitetin e prokurimit "Marrja me Qera e Makinerive te Renda" me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11613-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.
2. Mbetet në fuqi B58- Njoftimi mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues – Policia e Kosovës, i dates, 27.02.2026, për anulimin e aktivitetit prokurimit prokurimit "Marrja me Qera e Makinerive te Renda" me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11613-2-2-1".
3. Në përputhje me nenin 31 pika 5, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorve ekonomik ankues OE" ALL STONE "SH.P.K dhe OE" Company Murseli "SH.P.K, i konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës, kurse mjetet kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

### **Arsyetim**

-Faktet dhe rrethanat procedurale -

POLICIA E KOSOVËS, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues me datë 31.12.2025 ka publikuar Njoftimin për Kontratë B05 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA”, me numër të prokurimit 214/30400-25-11613-2-2-1.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës:shërbim, vlera e parashikuar e kontrates: 124,212.00

Me datën 27.02.2026 AK POLICIA E KOSOVËS, ka publikuar njoftimin mbi vendimin (B58) ku ka anuluar aktivitetin e prokurimit me titull: “MARRJA ME QERA E MAKINERIVE TE RENDA”, me numër të prokurimit 214/30400-25-11613-2-2-1.

Me datën 04.03.2026 Operatoret Ekonomik OE ALL STONE SH.P.K., si dhe OE Company Murseli SH.P.K., ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim kundër Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues për anulim të kontratës. Vendimi mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim është i datës 12.03.2026.

Kundër vendimit të cituar si më sipër me datën 23.03.2026 OE ALL STONE SH.P.K., ka parashtruar në OSHP ankesën nr. 2026/0179 (Nr. protokolli) si dhe OE Company Murseli SH.P.K., ankesën nr. 2026/0180 (Nr. protokolli).

Në fazën e shqyrtimit paraprak:

(a) OSHP ka konstatuar se ankesa në rastin konkret është ushtruar në pajtim me nenin 109.1 të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK, çdo palë e interesuar mund të parashtrrojë ankesë pas zbatimit të procedurës paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve, sikurse parashihet me nenin 108/A të këtij ligji. Meqë ankuesi ka statusin e palës së interesuar sikurse përkufizohet me nenin 105, paragrafi 1, lidhur me nenin 4, paragrafi 1.26 të LPP, kurse ankesa përmban elementet qenësore të parapara me nenin 111, të Ligjit të cituar, që do të thotë se e njëjta i plotëson kushtet në kuptim të dispozitave të cituara dhe bije nën kompetencat e këtij organi në kuptim të nenit 105, të LPP, lidhur me nenin 9, të Rregullores për Punën e OSHP. Paneli Shqyrtues analizoi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë të gjitha aktet dhe/ose veprimet e palëve, siç janë përshkruar më sipër (faktet dhe rrethanat procedurale) nuk ekzistojnë elementet për parandalim të konfliktit të interesit, siç kërkohet në kuptim të nenit 11 të Rregullores për Punën e OSHP, lidhur me paragrafin 1.75, të nenit 4 të LPP.

(b) Duke marrë parasysh faktin se të dy ankesat janë të ndërlidhura me aktivitetin e njëjtë të prokurimit përkatësisht me njoftimin mbi vendimin e njëjtë të Autoritetit Kontraktues lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, është vendosur që ankesa nr. 2026/0179 dhe ankesa nr. 2026/0180 të bashkohen dhe të trajtohen si rast i unifikuar në kuptim të nenit 16 paragrafit 1 të Rregullores nr. 01/2020 të Punës së Organit Shqyrtues të Prokurimit.

*-Përgjigje e AK-së lidhur me Krkesën për rishqyrtim të OE ankues ALL STONE SH.P.K.*

AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 1, pasi që qëllimi i aktivitetit është marrja e shërbimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit, dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë, duke përcaktuar kushtet dhe rregullat

që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga operatorët ekonomik që marrin pjesë ose interesohen në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla.

Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publikë, nëpunësve civilë dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit, duke kërkuar që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohen me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji, andaj ky pretendim i OE është i pabazuar.

AK nuk e ka shkelur Nenin 7 të LPP-së, pasi të gjithë OE janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe specifikave teknike. Po ashtu, AK nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE përmes kësaj procedure. AK ka hartuar specifikat teknike të cilat janë në harmoni me LPP dhe nuk kanë asnjë kufizim apo favorizim, dhe ofertat e juaja janë trajtuar në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes dhe specifikat teknike, andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

AK nuk ka shkelur Nenin 52 të LPP-së dhe Nenin 27 të Rregullores për njoftimin e kritereve për dhënien e kontratës. AK në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë ka përcaktuar kriteret kualifikuese dhe kriterin për dhënien e kontratës, ku kriter për dhënie të kontratës ka qenë oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë. Andaj AK ka respektuar Nenin 52 dhe ka rekomanduar për anulim aktivitetin e prokurimit sepse të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme.

Oferta e OE ankues është e papërgjegjshme për pikat në vijim: sipas Nenit 4.1 pika C të Rregullores nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores nr. 001/2022 për prokurimin publik, gjatë administrimit të procedurave të prokurimit Autoriteti Kontraktues do të ketë obligim të sigurohet që çmimi i kontraktuar nuk është më i lartë se çmimi i tregut. Ju keni ofruar çmime shumë herë më të larta se çmimet reale të tregut dhe çmimet e parashikuara nga AK për artikujt në vijim: Pjesa A: Pz.2; Pjesa B: Pz.1, Pz.2, Pz.3, Pz.4; Pjesa C: Pz.1, Pz.2, Pz.3, Pz.4, Pz.5.

AK ka kërkuar sqarime për çmime abnormalisht të larta dhe, në pajtim të plotë me LPP-në, ka kërkuar sqarime, për çka kemi edhe interpretim të KRPP-së ku thuhet se vlen e njëjta rregull si për çmimet abnormalisht të ulëta ashtu edhe për çmimet abnormalisht të larta. Sqarimi është kërkuar se si është arritur formulimi i këtyre çmimeve për artikujt e lartpërmendur.

Komisioni i vlerësimit ka pranuar përgjigje lidhur me sqarimet e kërkuara, por pas vlerësimit të tyre nuk janë konsideruar bindëse, sepse çmimet e ofruara janë shumë të larta në krahasim me vlerën e parashikuar nga AK. Duke iu referuar interpretimit të KRPP-së, AK ka kërkuar sqarime gjatë fazës së parë të vlerësimit mbi çmimet shumë herë më të larta se ato reale në treg, ndërsa OE ka ofruar vetëm një zbërthim, por asnjë dëshmi apo dokumentim se si ka arritur deri te formulimi i këtyre çmimeve, andaj ky pretendim është i pabazuar.

AK nuk ka shkelur Nenin 56 të LPP-së dhe Nenin 25 të Rregullores, pasi OE ankues nuk është eliminuar për asnjë kriter apo kërkesë që nuk ka qenë në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. OE është eliminuar duke iu referuar Nenit 4.1 pika C të Rregullores nr. 002/2024, ku kërkohet që çmimi i kontraktuar të mos jetë më i lartë se çmimi i tregut, pasi çmimet e ofruara janë shumë herë më të larta se çmimet e planifikuara nga AK, të cilat janë bërë në bazë të hulumtimit të tregut.

AK nuk ka shkelur Nenin 59 të LPP-së dhe Nenin 40 të Rregullores për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e njoftimit për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike. AK ka bërë ekzaminimin dhe vlerësimin në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese. Oferta juaj është e papërgjegjshme për shkak të çmimeve shumë herë më të larta se vlera e parashikuar nga AK.

AK nuk ka shkelur Nenin 60 të LPP-së, pasi aktiviteti është rekomanduar për anulim në mungesë të një oferte të përgjegjshme.

AK nuk ka shkelur Nenin 61 të LPP-së dhe Nenin 41 të Rregullores, pasi ka kërkuar sqarime për çmimet shumë herë më të larta se ato reale në treg dhe sqarimet nuk kanë qenë bindëse.

AK nuk ka shkelur Nenin 69 të LPP-së, pasi ankuesi nuk ka dhënë detaje konkrete për këtë pretendim dhe eliminimi lidhet me tejkalimin e çmimeve për njësi.

AK nuk ka shkelur Nenin 72 të LPP-së dhe Nenin 38 të Rregullores, pasi ka kërkuar sqarime shtesë për çmimet dhe i ka vlerësuar ato si të pabindshme.

AK nuk ka shkelur Nenin 4.1 të Rregullores nr. 002/2024, pasi ka kërkuar sqarime dhe OE nuk ka ofruar dëshmi për formulimin e çmimeve.

AK nuk ka shkelur Nenin 61 të Rregullores, pasi pezullimi i aktivitetit është bërë pas pranimit të kërkesës për rishqyrtim dhe është ngarkuar në platformën e E-prokurimit.

AK nuk ka shkelur Nenin 97 të Rregullores nr. 002/2024, pasi komisioni i vlerësimit ka kryer vlerësim të pavarur pa presion apo ndikim dhe në harmoni të plotë me LPP. Sipas Nenit 4.1 pika C të Rregullores, OE ka ofruar çmime shumë herë më të larta se çmimet reale të tregut dhe çmimet e parashikuara nga AK, andaj ky pretendim i OE është i pabazuar.

*-Përgjigje e AK-së lidhur me Kërkesën për rishqyrtim të OE ankues Company Murseli SH.P.K.*

- AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 1, pasi qëllimi i aktivitetit është marrja e shërbimeve plotësisht sipas kërkesave të AK dhe kriteret janë përcaktuar në përputhje me qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe si rrjedhojë AK ka siguruar mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë duke përcaktuar kushtet dhe rregullat që do të zbatohen, procedurat që do të ndiqen, të drejtat që do të respektohen dhe detyrimet që do të përmbushen nga operatorët ekonomik që marrin pjesë ose interesohen në aktivitetet e prokurimit ose që përfshihen ose kanë të bëjnë me fondet dhe/ose burimet e tilla. Ky ligj gjithashtu ka për qëllim të sigurojë integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla të mos ndikohen nga interesat personale, të karakterizohen me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lartë të transparencës dhe të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji, dhe ky pretendim i OE është i pabazuar.

- AK nuk ka bërë shkelje të Nenit 6 pasi që AK e ka zbatuar këtë nen sipas LPP-së ku të gjitha autoritetet kontraktuese janë të obliguara që të sigurojnë që fondet publike dhe burimet publike të përdoren në mënyrën më ekonomike, njëkohësisht duke marrë në konsideratë qëllimin dhe

lëndën e prokurimit. Fondet publike dhe burimet publike që janë ofruar ose që janë vënë në dispozicion sipas një kontrate publike mund të përdoren vetëm nga kontrata e tillë dhe vetëm për qëllimet e të njëjtës. Në këtë rast AK ka zbatuar në harmoni të plotë këtë nen duke rekomanduar për anulim të këtij aktiviteti për shkak se asnjëra ofertë nuk ka qenë e përgjegjshme sipas vlerësimit të AK. Andaj vendimi i AK për anulim të këtij aktiviteti është bërë në harmoni me LPP-në dhe ky pretendim i OE është i pabazuar.

- AK nuk e ka shkelur Nenin 7 të LPP-së pasi të gjithë OE janë trajtuar në mënyrë të barabartë sipas kërkesave në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë dhe specifikave teknike, po ashtu AK nuk ka diskriminuar apo favorizuar asnjë OE përmes kësaj procedure. AK ka hartuar specifikat teknike të cilat janë në harmoni me LPP dhe nuk kanë asnjë kufizim apo favorizim dhe ofertat e juaja janë trajtuar në harmoni të plotë me kërkesat e dosjes dhe specifikat teknike, andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar. AK nuk ka shkelur nenin 52 të LPP-së “Njoftimi i kriterëve për dhënien e kontratës”, AK në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë ka përcaktuar kriteret kualifikuese dhe kriterin për dhënie të kontratës ku kriter për dhënie të kontratës ka qenë Oferta e përgjegjshme me çmimin më të lirë, andaj AK ka respektuar nenin 52 dhe ka rekomanduar për anulim aktivitetin e prokurimit sepse të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme.

- Oferta juaj ka qenë e papërgjegjshme sepse nuk ka plotësuar kriter administrative të kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

- AK nuk ka shkelur Nenin 59 dhe Nenin 40 “Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve” RREGULLORE NR.002/2024 PËR PLOTËSIMIN DHE NDRYSHIMIN E RREGULLORES NR.001/2022 PËR PROKURIMIN PUBLIK. Autoriteti kontraktues do të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm vetëm nëse tenderi në fjalë është në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara me njoftimin për kontratë, FDT dhe specifikimet teknike të detyrueshme Aneksi 1. Andaj AK ka bërë ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e të gjitha ofertave në mënyrë të barabartë dhe jo diskriminuese dhe në përputhshmëri me të gjitha kërkesat e parashtruara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Oferta juaj është e papërgjegjshme për pikën në vijim:

Në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë dhe FDT është kërkuar kriter:

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional – Dëshmia e kërkuar dokumentare:

Bulldozer me goma min. 30 ton – 1 copë

Eskavator për hapjen e kanaleve min. 25 ton – 2 copë

Kamion transportues të peshave të rënda min. 35 ton – 2 copë

Vinç për pesha të rënda min. 12 tonë – 1 copë

Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve min. 5 tonë – 1 copë

Autobartëse kran për transportimin e automjeteve të palëvizshme me peshë bartëse min. 10 tonë – 1 copë

Lygë ngarkuese min. 25 ton – 1 copë

Eskavator me lopatë dhe pirunier teleskopik – 1 copë

Dëshmi: OE duhet të ofrojë listën e makinerisë të kërkuara për ekzekutim të shërbimeve/punëve të vulosur dhe nënshkruar si në vijim:

10. Bager me lugë min. 18 ton – 2 copë

11. Bulldozer me goma min. 30 ton – 1 copë

3. Eskavator për hapjen e kanaleve min. 25 ton – 2 copë

4. Kamion transportues të peshave të rënda min. 35 ton – 2 copë

5. Vinç për pesha të rënda min. 12 tonë – 1 copë

6. Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve min. 5 tonë – 1 copë

7. Autobartëse kran për transportimin e automjeteve të palëvizshme me peshë bartëse min. 10 tonë – 1 copë

8. Lygë ngarkuese min. 25 ton – 1 copë

9. Eskavator me lopatë dhe pirunier teleskopik – 1 copë

OE ka dorëzuar listën e pajisjeve dhe marrëveshjet, por marrëveshjet e dorëzuara nuk janë të noterizuara sipas njoftimit për kontratë dhe FDT. AK ka kërkuar sqarime në lidhje me kriterin e lartcekur për marrëveshjet e noterizuara, por OE edhe pas përgjigjeve nuk arrin ta dëshmojë dokumentin sipas njoftimit për kontratë dhe FDT. Andaj oferta juaj është refuzuar si e papërgjegjshme sepse nuk keni plotësuar kriterin e kërkuar në njoftim për kontratë dhe dosjen e tenderit. Për të gjitha kriteret e vendosura sipas njoftimit për kontratë dhe FDT çdo OE ka pasur të drejtën ligjore të kërkojë sqarime gjatë fazës së tenderimit. AK nuk ka pranuar asnjë kërkesë për sqarime mbi Kapacitetin teknik dhe profesional nga asnjë OE i interesuar për këtë aktivitet të prokurimit. Andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

- AK nuk ka shkelur nenin 60 “Kriteret për Dhënien e Kontratës”. Pretendimet për shkelje të nenit 60 të LPP-së janë të pabazuara pasi aktiviteti është rekomanduar për anulim në mungesë të një oferte të përgjegjshme, ndërsa oferta juaj është e papërgjegjshme pasi nuk keni plotësuar kriterin e lartpërmendur dhe të shtjelluar tek Kapaciteti teknik dhe profesional sipas njoftimit për kontratë dhe FDT.

- AK nuk e ka shkelur Nenin 62 – Përfundimi i Aktivitetit të Prokurimit dhe nenin 43 të Rregullores 02/2022 për Prokurimin Publik (RRPP 002/2024). AK ka vepruar në harmoni të plotë me LPP dhe ka anuluar aktivitetin e prokurimit pasi janë plotësuar rrethanat për anulim sipas pikës (b) të nenit 43 ku thuhet “asnjëri prej tenderëve të pranuar nuk është i përgjegjshëm”, andaj ky pretendim ankimor është i pabazuar.

- Si përfundim, AK nuk ka shkelur asnjë nga nenet e lartcekura nga OE ankues pasi gjatë vlerësimit ka respektuar të gjitha kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, të gjitha dispozitat e LPP dhe legjislacionit dytësor duke u siguruar se ofertat e dorëzuara janë në pajtim të plotë me kërkesat dhe kriteret e kërkuara në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë, dhe si përfundim pretendimet ankimore të OE janë të pabazuara.

• AK nuk ka shkelur nenin 72 “Dokumentacioni dhe informacioni shtesë”. AK ka kërkuar sqarim shtesë nga OE në lidhje me përmbushjen e kriterit të lartpërmendur të kërkuar në dosjen e tenderit dhe njoftimin për kontratë. AK ka pranuar sqarimet nga OE, por edhe pas sqarimit OE nuk arrin ta plotësojë kriterin e kërkuar sipas njoftimit për kontratë dhe FDT. Prandaj ky pretendim i OE është i pabazuar.

*- Pretendimet e operatorit ekonomik ankues ALL STONE SH.P.K., ne ankesën Nr. 0179/2026 janë parashtruar si në vijim:*

Me datën 1 janar 2026, AK – “Policia e Kosovës”, përmes platformës publike e-prokurimi, ka shpallur iniciimin e aktivitetit të prokurimit me titull: “Marrja me qira e makinerive të rënda”, me nr. prokurimi: 214/30400-25-11613-2-2-1.

Kompania jonë, Operatori Ekonomik ALL STONE SH.P.K., ka marrë pjesë në këtë aktivitet të prokurimit duke dorëzuar dosjen e tenderit brenda afatit të përcaktuar ligjor dhe duke i plotësuar të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit. Në këtë aktivitet të prokurimit janë pranuar katër oferta: Company Murseli SH.P.K. me çmim 98.80 €, ALL STONE SH.P.K. me çmim 199.66 €, ETEAM SH.P.K. me çmim 258.83 € dhe DARDANIAA SH.P.K. me çmim 1,360.00 €.

Autoriteti Kontraktues, me datën 27.02.2026, ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e AK-së, me të cilin rekomandon anulimin e aktivitetit me arsyetimin se të gjitha ofertat janë të papërgjegjshme, duke mos zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat procedurale dhe materiale të LPP-së.

Menjëherë pas pranimit të këtij vendimi, me datën 27.02.2026 kemi paraqitur kërkesë për qasje në dokumente zyrtare, ndërsa qasja është mundësuar më 02.03.2026. Pas analizimit të këtyre dokumenteve, rezulton se gjatë procedurës formale të vlerësimit të tenderëve dhe nxjerrjes së vendimeve kontradiktore, AK nuk ka zbatuar në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme dispozitat procedurale dhe materiale të LPP-së, pasi gjatë mënyrës dhe metodës së vlerësimit, ekzaminimit dhe krahasimit të tenderëve nuk ka vepruar në përputhje me kërkesat e përcaktuara në njoftimin për kontratë, dosjen e tenderit dhe dispozitat ligjore që përcaktojnë trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë në procesin e vlerësimit.

Në vijim do të ofrojmë një deklaratë të qartë, të detajuar dhe të faktuar me argumente të bazuara për secilin pretendim ankimor që parashtrujmë në këtë ankesë kundër vendimit të AK-së, nga të cilat vërehet lehtësisht se AK ka vepruar në kundërshtim me LPP-në, duke mos i përfillur kërkesat që vetë i ka parashtruar në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë lidhur me kriteret e përzgjedhjes dhe kriterin e dhënies së kontratës, duke shkelur parimet bazike të vlerësimit në prokurimin publik.

**Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore**

Nga Sektori i Prokurimit i AK-së, me vendimin e datës 12.03.2026, është refuzuar si e pabazuar kërkesa jonë për rishqyrtim, me një arsyetim të përgjithshëm dhe të paargumentuar me fakte dhe prova konkrete. Gjatë procedurës së shqyrtimit të kërkesës për rishqyrtim kanë ndodhur një mori shkeljesh procedurale dhe materiale, të cilat paraqiten në vijim.

Konstatimet në të gjitha pikat e vendimit të AK-së janë të mangëta dhe të pabazuara në faktet vendimtare të shkresave të lëndës, në faktet e paraqitura nga ne, në kërkesat e dosjes së tenderit dhe në dispozitat e LPP-së. Nga ky vendim shihet qartë se AK i ka trajtuar në mënyrë

sipërfaqësore dhe selektive pretendimet tona, duke shmangur detyrimet ligjore dhe duke anashkaluar faktet vendimtare dhe rrethanat e rastit konkret, çka ka sjellë një pasqyrim të gabuar të gjendjes faktike dhe një përshkrim të pasaktë ligjor me qëllim mohimin e të drejtës sonë për rivlerësim të drejtë të procesit.

Për rrjedhojë, arsyetimi i vendimit të atakuar nuk e ka vërtetuar drejt gjendjen faktike dhe është zbatuar gabimisht e drejta materiale e LPP-së (neni 108/A), përfshirë edhe keqinterpretimin e kërkesave të dosjes së tenderit. Arsyet e dhëna në vendimin e AK-së nuk janë të bazuara në dispozitat e LPP-së dhe legjislacionit dytësor RRPP nr. 001/2022, ndërsa arsyetimi është në kundërshtim edhe me nenin 48 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Një ndër shkeljet thelbësore në këtë procedurë është fakti se AK nuk ka përcaktuar asnjë çmim referent apo vlerë të parashikuar për pozicionet e tenderit. Në mungesë të një çmimi referent, AK ka qenë e obliguar që vlerësimin e ofertave ta bëjë në mënyrë objektive dhe të bazuar në analiza reale të tregut, në përputhje me parimet themelore të prokurimit publik, e jo në vlerësime subjektive dhe të paargumentuara.

Nga vendimi i kontestuar rezulton se AK ka bërë vlerësime arbitrare lidhur me çmimet e ofertuara, pa ofruar analizë krahasimore apo dëshmi të tregut që do të justifikonin konstatimet e saj. Një qasje e tillë bie ndesh me parimin e transparencës, trajtimit të barabartë dhe konkurrencës së drejtë sipas LPP-së. Për më tepër, mungesa e çmimit referent e bën të pamundur çdo konstatim të qëndrueshëm lidhur me çmime jonormale apo devijime eventuale, andaj çdo pretendim i AK-së në këtë drejtim është i papabuar dhe në kundërshtim me standardet e prokurimit publik.

Rrjedhimisht, duke mos pasur bazë të qartë krahasuese dhe duke mos arsyetuar mjaftueshëm vendimin e saj, AK ka dështuar të vërtetojë drejt gjendjen faktike, duke rezultuar në një vendimmarrje të gabuar dhe në kundërshtim me dispozitat materiale dhe procedurale në fuqi.

Përshkrimi faktik dhe ligjor i pretendimeve ankimore – Pretendimet mbi Vendimin e AK-së të datës 27.02.2026.

#### Pretendimi i parë (1)

Autoriteti Kontraktues ofertën tonë e ka cilësuar si të papërgjegjshme, me arsyetimin se këto arsyetime nuk janë të bazuara dhe nuk e pasqyrojnë realitetin dhe gjendjen faktike, por si të tilla paraqesin fakte të rreme me qëllim të justifikimit të këtij vendimi, i cili është në kundërshtim me parimet dhe kriteret e nenit 59 dhe nenit 69 të LPP-së, lidhur me nenin 40 paragrafët 1, 2 dhe 6 të RrPP nr. 001/2022.

Së pari, AK nuk ka realizuar asnjë hulumtim të tregut. Arsyetimi i eliminimit i theksuar është vetëm një kamuflim për të dhënë përshtypjen se asgjë e paligjshme nuk po ndodh, me qëllim që të arrihet rezultati i dëshiruar nga ana e AK-së.

Së dyti, AK me datë 28.01.2026 ka kërkuar sqarime në lidhje me çmimet e ofruara nga ana jonë dhe ne, me datë 30.01.2026, kemi dorëzuar një sqarim të detajuar lidhur me këto çmime. Në këtë kërkesë për sqarime në çmim, AK ka vlerësuar të gjitha pozicionet (përveç pozicionit A.1) si pozicione me çmime të larta sipas tyre, pa paraqitur asnjë hulumtim tregu dhe pa treguar se si janë bërë krahasimet e çmimeve për të konkluduar se këto janë çmime të larta sipas nenit 4.1.c.

Megjithatë, edhe përkundër kësaj, ne kemi paraqitur një shpjegim të detajuar lidhur me këtë çështje.

Së treti, sipas dispozitave procedurale dhe qenësore të LPP-së, gjegjësisht nenit 59.4 të këtij ligji lidhur me nenin 41 të RrPP-së, AK është i autorizuar të bëjë vlerësimin e tenderëve në pajtim me këtë ligj dhe me të gjitha dispozitat e legjislacionit dytësor të nxjerrë nga KRPP, duke u bazuar në kërkesat e paraqitura në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit. Në këtë kuptim, në kushtet e përcaktuara për pjesëmarrje në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, AK nuk ka paraqitur asnjë kërkesë lidhur me çmimet referente për pjesët e tenderit (sipas paramasës dhe parallogarisë së punëve), pra nuk ka vendosur çmim tavan që do të përcaktonte nivelin minimal dhe maksimal të çmimit mbi të cilin OE duhet të mbështeten gjatë përgatitjes së ofertave financiare dhe që AK duhet të përdorte gjatë vlerësimit të tenderëve si mjet ndihmës. Duke qenë se në dosjen e tenderit nuk janë paraqitur çmime referente dhe nuk është vendosur minimum apo maksimum i çmimit tavan (përveç vlerës së parashikuar të kontratës), shtrohet pyetja se mbi cilën bazë është mbështetur AK për të vlerësuar një çmim si “të lartë”, kur as nuk plotësohet kushti ligjor dhe as nuk është përcaktuar në kushtet e pjesëmarrjes në DT.

Fillimisht, para se të paraqesim dëshmitë tona lidhur me këto pozicione, ju njoftojmë se oferta jonë nuk mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët apo e lartë, siç përcaktohet me nenin 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik, dhe nuk dihet qëllimi i AK-së pse ofertën tonë e ka konsideruar si të tillë.

a) Pozicioni A.2 – Hapja e kanaleve me pajisje të rënda, eskavator minimum 25 ton

Çmimi i ofruar njësi: 285.00 €/orë.

Lidhur me këtë pozicion, sqarojmë se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë, për të cilën nuk është i njohur paraprakisht lokacioni i punimeve, kohëzgjatja e ndërhyrjes apo distanca e transportit të makinerisë, çka paraqet rrezik ekonomik të drejtpërdrejtë për operatorin ekonomik. Në përshkrimin e pozicionit është përcaktuar qartë se në çmim duhet të përfshihet transporti i makinerisë deri në vendin e punimeve, ndërsa pagesa llogaritet vetëm nga fillimi i kryerjes së punimeve, pa u kompensuar koha dhe kostoja e transportit.

Eskavatorët me peshë minimale 25 ton kanë kosto të larta operative, duke përfshirë shpenzime të konsiderueshme të karburantit, servis të specializuar, amortizim të shpejtë të pajisjes dhe kosto shtesë për transport me mjete të posaçme. Në praktikë mund të ndodhë që makineria të transportohet në distanca deri në 80 km, ndërsa ndërhyrja në terren të zgjasë vetëm 1–2 orë, për çka operatori paguhet vetëm për kohën e punës (p.sh. 570 € për 2 orë), ndonëse kostoja reale e shërbimit është dukshëm më e lartë. Për më tepër, ekziston edhe rreziku i dëmtimit të pajisjes dhe rrethanat e paparashikueshme të sigurisë, të cilat mbeten përgjegjësi e operatorit ekonomik. Për këto arsye, çmimi prej 285.00 €/orë është plotësisht i arsyetuar ekonomikisht dhe nuk mund të konsiderohet çmim jo-normalisht i lartë.

b–e) Pozicionet B.1 – B.4 – Mbajtja në posedim e pajisjeve të rënda

Çmimet e ofruara: 13.80 €/orë, 13.50 €/orë, 14.50 €/orë dhe 15.50 €/orë.

Këto pozicione kanë të njëjtën natyrë shërbimi, përkatësisht mbajtjen në posedim të pajisjeve të rënda dhe jo operimin aktiv të tyre. Transporti, përgatitja teknike, mirëmbajtja, sigurimi dhe gatishmëria teknike mbesin barrë e operatorit ekonomik. Mbajtja në posedim nënkupton kosto të

vazhdueshme, përfshirë amortizimin, mirëmbajtjen, sigurimin, personelin teknik dhe bllokimin e pajisjeve nga angazhime të tjera komerciale. Duke qenë se bëhet fjalë për kontratë kornizë, kohëzgjatja e mbajtjes në posedim nuk është e paracaktuar, çka rrit rrezikun ekonomik për operatorin.

Çmimet e ofruara janë minimale dhe ekonomike, përfaqësojnë vetëm kompensim bazik për kostot e mbajtjes në posedim dhe janë të favorshme për AK. Për shembull, nëse një pajisje mbetet në mbajtje për 24 orë, pagesa ditore do të ishte rreth 330–370 €, që është kompensim minimal dhe shumë më i ulët se të ardhurat që do të gjeneroheshin nga përdorimi aktiv në treg.

f–j) Pozicionet C.1 – C.5 – Transportimi i pajisjeve dhe materialeve

Çmimet e ofruara: 14.90 €/km, 15.75 €/km, 15.15 €/km, 16.25 €/km dhe 9.95 €/km.

Këto pozicione përfshijnë ngarkimin, transportin dhe shkarkimin e pajisjeve, makinerive dhe materialeve. Shërbimi përfshin kosto të konsiderueshme operative: karburant, amortizim, mirëmbajtje, sigurim, personel të kualifikuar dhe përdorimin e mjeteve të specializuara. Duke qenë kontratë kornizë, distancat nuk janë të paracaktuara, çka rrit rrezikun për operatorin ekonomik.

Për ilustrim, transportimi i një pajisjeje mbi 35 ton në distancë 15 km do të paguhej vetëm 223.50 €, ndërsa transportimi i një kontejneri në 10 km vetëm 157.50 €. Transportimi i automjeteve të palëvizshme në 10 km do të paguhej 162.50 €, ndërsa transportimi i dheut për 2 km vetëm 19.90 € për kamion 20 ton, që praktikisht nënkupton rreth 1 € për ton. Këto vlera dëshmojnë se çmimet janë reale, konkurruese dhe jo çmime jo-normalisht të larta.

Në përfundim, në kushtet e pjesëmarrjes dhe në dosjen e tenderit AK nuk ka paraqitur çmime referente apo çmim tavan për pozicionet e tenderit, prandaj nuk ekziston bazë ligjore dhe faktike mbi të cilën AK mund të mbështetet për ta vlerësuar ofertën tonë si me “çmime të larta”.

Atëherë, duke pasur parasysh se në dosjen e tenderit nuk janë paraqitur çmimet referente mbi të cilat operatorët ekonomikë duhet të mbështeten gjatë përgatitjes së ofertës financiare, si dhe nuk është vendosur asnjë minimum apo maksimum i çmimit tavan (përveç vlerës së parashikuar të kontratës), shtrohet pyetja mbi cilën bazë është mbështetur Autoriteti Kontraktues për ta vlerësuar ofertën tonë si “çmim të lartë”.

Po ashtu, sipas rendit kushtetues në Republikën e Kosovës, Kushtetuta është akti më i lartë juridik dhe të gjitha ligjet dhe aktet e tjera juridike duhet të jenë në pajtim me të, ndërsa çdo person dhe organ shtetëror i nënshtrohet dispozitave të saj. Në këtë kuptim, rendi kushtetues i Republikës së Kosovës, në kuadër të rregullimit ekonomik, e përcakton si bazike të drejtën e ekonomisë së tregut me konkurrencë të lirë, duke siguruar një mjedis të favorshëm dhe ligjor për lirinë e aktivitetit ekonomik. Si rrjedhojë, sipas parimit kushtetues dhe legjislacionit pozitiv në fuqi, autoritetet shtetërore – në rastin konkret Autoriteti Kontraktues – nuk kanë të drejtë të ndërhyjnë dhe të kontrollojnë strategjinë apo aftësinë konkurruese financiare të operatorëve ekonomikë përmes çmimeve të tregut, të cilat përcaktohen nga raporti ofertë–kërkesë dhe nga gjykimi i pavarur i operatorëve ekonomikë.

Rrjedhimisht, të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ana jonë janë të qëndrueshme, përputhen plotësisht me kërkesat e dosjes së tenderit dhe dëshmojnë qartë kapacitetin teknik për zbatimin e shërbimeve të përcaktuara në këtë aktivitet të prokurimit.

Në lidhje me këtë çështje ekzistojnë edhe një sërë rastesh të gjykuara nga OSHP, konkretisht vendimet nr. 354/19, 752/19, 850/20, 1044/20, 224/22 dhe 306/22, në të cilat paneli shqyrtues ka obliguar autoritetet kontraktuese që vlerësimi i ofertave të bëhet në çmimin e tërësishëm dhe jo në bazë të pozicioneve individuale, në mënyrë që të konstatohet nëse çmimi i ofruar është çmim tregu.

Sa i përket eliminimit të operatorëve të tjerë ekonomikë pjesëmarrës në këtë aktivitet të prokurimit, pajtohem me vendimin e Autoritetit Kontraktues, pasi të gjithë rezultojnë të jenë të përgjegjshëm.

#### Pretendimi i dytë (II)

Komisioni i vlerësimit ka vepruar në kundërshtim me nenin 59.1 të LPP-së dhe nenin 40.1 të Rregullores për Prokurim Publik, pasi ka qenë i obliguar të vlerësojë dhe të krahasojë vetëm tenderët e përgjegjshëm, duke u mbështetur në kriteret për dhënien e kontratës të përcaktuara në njoftimin për kontratë dhe në dosjen e tenderit.

Gjithashtu, sipas nenit 40.13 të Rregullores për Prokurim Publik, procesi i vlerësimit duhet të kryhet në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara paraprakisht dhe pa devijime nga kërkesat ligjore dhe dokumentacioni i tenderit. Në këtë rast, komisioni nuk e ka respektuar këtë obligim, pasi ka përfshirë në proces edhe tenderë që objektivisht nuk ishin të përgjegjshëm dhe nuk përmbushnin kriteret teknike dhe administrative të kërkuara.

Kjo mënyrë veprimi ka ndikuar drejtpërdrejt në rezultatin përfundimtar të aktivitetit të prokurimit dhe përbën shkelje të parimeve të ligjshmërisë, barazisë dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë të garantuara nga LPP.

#### Pretendimi i tretë (III)

Autoriteti Kontraktues ka bërë shkelje të rëndë sipas nenit 97.1.o të Rregullores për Prokurim Publik, pasi nga provat e paraqitura dëshmohet se kemi të bëjmë me sjellje të gabuar dhe joprofesionale të zyrtarit përgjegjës të prokurimit ndaj kompanisë sonë. Ky i fundit është i obliguar, sipas nenit 39.4 të Rregullores për Prokurim Publik, të organizojë punën e komisionit vlerësues dhe të sigurojë respektimin e dispozitave të LPP-së.

Në këtë rast, zyrtari përgjegjës ka dështuar të përmbushë këtë obligim ligjor, duke lejuar veprime dhe vendime që kanë cenuar parimin e ligjshmërisë, barazisë dhe trajtimit të drejtë të operatorëve ekonomikë.

Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar nenin 7 të LPP-së, ndonëse kompania jonë ka përmbushur të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë, por megjithatë nuk është rekomanduar për kontratë.

Paragrafi 1 i nenit 7 parasheh qartë se Autoriteti Kontraktues duhet t'i trajtojë operatorët ekonomikë në mënyrë të barabartë dhe jodiskriminuese dhe të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa paragrafi 6 përcakton se gjatë udhëheqjes së aktivitetëve të prokurimit duhet të sigurohet që tenderi i zgjedhur të përputhet me të gjitha aspektet përmbajtësore të kushteve, kriterëve dhe specifikimeve përkatëse.

Prandaj, faktet dhe rrethanat e lartcekura vërtetojnë se vendimi i Autoritetit Kontraktues është i kundërligjshëm, pasi gjatë procedurës së vlerësimit është vendosur në dëm të ofertës së operatorit ekonomik ankues, duke na mohuar të drejtën e ligjshme për shpërbllim me kontratë, pavarësisht faktit se kemi paraqitur ofertë të përgjegjshme dhe me çmimin më të ulët. Duke marrë parasysh se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e sipërpërmendura të LPP-së dhe akteve nënligjore, si dhe se si pasojë e këtyre shkeljeve jemi dëmtuar drejtpërdrejt, kërkojmë nga OSHP që të marrë në konsideratë dhe të vlerësojë të gjitha faktet e paraqitura në këtë ankesë.

*- Pretendimet e operatorit ekonomik ankues Company Murseli SH.P.K., në ankesën 2026/0180 janë parashtruar si në vijim:*

Me datë 27.02.2026 kemi marrë Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, me të cilin është anuluar aktiviteti i prokurimit, ndërsa njëkohësisht kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin se:

Dëshmia 1: OE duhet të ofrojë listën e makinerive të kërkuara për ekzekutimin e shërbimeve, të vulosur dhe të nënshkruar, si në vijim:

Bager me lugë min. 18 ton – 2 copë

Bulldozer me goma min. 30 ton – 1 copë

Eskavator për hapjen e kanaleve min. 25 ton – 2 copë

Kamion transportues të peshave të rënda min. 35 ton – 2 copë

Vinç për pesha të rënda min. 12 ton – 1 copë

Kamion me kran për ngarkimin e kontejnerëve min. 5 ton – 1 copë

Autobartëse kran për transportimin e automjeteve të palëvizshme me peshë bartëse min. 10 ton – 1 copë

Lygë ngarkuese min. 25 ton – 1 copë

Eskavator me lopatë dhe pirunier teleskopik – 1 copë

Të dëshmohet me librezë valide për makineritë (nëse makineria regjistrohet), ndërsa nëse OE nuk i ka në pronësi, të dëshmohen kontratat/marrëveshjet për marrje me qira, të cilat duhet të jenë të noterizuara.

Në dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë është kërkuar që Operatori Ekonomik të ofrojë listën mbi makineritë, të nënshkruar dhe të vulosur nga OE për makineritë e lartcekura. OE ka dorëzuar listën e pajisjeve si dhe marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre, mirëpo marrëveshjet e dorëzuara nuk kanë qenë të noterizuara sipas kriterit të kërkuar në FDT. AK ka kërkuar sqarime lidhur me marrëveshjet e noterizuara, por OE edhe pas përgjigjeve nuk ka arritur të plotësojë kriterin e kërkuar në FDT, andaj oferta është refuzuar si e papërgjegjshme.

Në lidhje me arsyen e eliminimit tonë nga ky aktivitet i prokurimit, sqarojmë se kemi ofruar listën e makinerive dhe marrëveshjet për shfrytëzimin e tyre, gjë që përmbush qëllimin e

kërkesës së dosjes së tenderit. Autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarime shtesë më datë 10.02.2026, ndërsa ne kemi ofruar përgjigjet më datë 13.02.2026, duke sqaruar se marrëveshjet janë valide dhe të nënshkruara nga palët përkatëse, përkatësisht qiradhënësi dhe qiramarrësi. Po ashtu kemi inkurajuar autoritetin kontraktues që, nëse ka ndonjë dilemë lidhur me këto makineri, të dalë në terren dhe t'i verifikojë ato.

Përkundër sqarimeve të ofruara, jemi eliminuar me arsyetimin se marrëveshjet nuk janë të noterizuara. Marrëveshjet për qira të makinerive janë të nënshkruara me kompanitë përkatëse me vullnet të plotë të palëve dhe janë plotfuqishme; dokumentet e bashkëngjitura janë skanuar nga origjinali dhe dorëzuar me ofertë.

Sa i përket noterizimit, kemi sqaruar se nuk i kemi noterizuar marrëveshjet duke u bazuar në nenin 26.16 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, ku përcaktohet se në rast dyshimi për informacionin e dorëzuar nga OE, Autoriteti Kontraktues duhet të kryejë kontroll efektiv të informatave dhe dokumentacionit tek autoriteti/personi fizik përkatës, dhe rrjedhimisht kërkesa për noterizim konsiderohet e panevojshme.

Kemi sqaruar se, nëse AK ka ndonjë dyshim, mund të kryejë kontroll efektiv konform nenit 52.7 të LPP-së. Marrëveshjet janë valide dhe makineritë janë në dispozicion për realizimin e projektit. Kemi qenë të gatshëm të dorëzojmë edhe origjinalet fizikisht tek AK ose tek OSHP nëse kërkohet.

Eliminimi ynë është mbështetur vetëm në mungesën e noterizimit, megjithëse marrëveshjet dëshmojnë disponueshmërinë e makinerive. Mungesa e noterizimit, duke marrë parasysh nenin 26.16 të RRPP Nr. 002/2024, nuk cenon vlefshmërinë juridike të marrëveshjeve dhe nuk ndikon në aftësinë tonë për realizimin e projektit. Eliminimi për një çështje formale që nuk prek substancën dhe është lehtësisht e verifikueshme është i pabazuar dhe tendencioz, pasi AK nuk ka treguar gatishmëri për kontroll efektiv.

Noterizimi është vetëm formalizim i nënshkrimeve, të cilat nuk janë kontestuar nga asnjë palë. Mosnoterizimi mund të konsiderohet devijim i vogël sipas nenit 59.4 pika (ii) të LPP-së, pasi nuk shkakton ndryshime materiale në ofertë.

Ne kemi pranuar vendimin për refuzim të kërkesës për rishqyrtim më datë 12.03.2026, pa arsye konkrete, ku AK vetëm ka përsëritur qëndrimet e saj pa kundërshtuar argumentet tona.

Ne kemi dëshmuar se marrëveshjet janë valide dhe plotësojnë qëllimin e kërkesës së dosjes së tenderit. Duke qenë se makineritë janë në dispozicion dhe kjo dëshmohet me marrëveshje të nënshkruara, mungesa e noterizimit është devijim i vogël sipas nenit 59.4 të LPP-së.

Nëse AK ka pasur dilema, ka pasur mekanizma ligjorë për verifikim, si kontaktimi i kompanive qiradhënëse apo verifikimi në terren, të cilat nuk janë ndërmarrë.

Rrjedhimisht, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë në përputhje me nenin 59 të LPP-së dhe nuk është respektuar kriteri i tenderit të përgjegjshëm me çmimin më të ulët sipas nenit 60 paragrafi 1.1 të LPP-së. Po ashtu nuk është respektuar neni 6 i LPP-së për përdorim ekonomik të fondeve publike.

Ne kemi qenë ofertuesi me çmimin më të ulët dhe kemi plotësuar kërkesat e dosjes së tenderit; anulimi i aktivitetit është në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së dhe nenet 43.5 dhe 43.7 të

RRPP Nr. 001/2022, pasi nuk janë plotësuar kushtet për anulim.

Në përfundim, konsiderojmë se kemi plotësuar të gjitha kërkesat dhe është dashur të rekomandohemi për kontratë. AK nuk ka respektuar nenin 7 të LPP-së për trajtim të barabartë dhe transparencë, duke na diskriminuar pa bazë ligjore. Prandaj kërkojmë rishqyrtimin e ofertës sonë dhe rekomandimin për kontratë, në përputhje me qëllimin e nenit 1 të LPP-së për përdorim efikas, transparent dhe të drejtë të fondeve publike.

- Administrimi dhe vlerësimi i provave –

Me qëllim të vërtetimit të plotë të gjendjes faktike, paneli shqyrtues ka administruar si prova raportin e ekspertit, mendimet e palëve lidhur me raportin e ekspertit, parashtresat dhe dokumentet e ankuesit, shkresat dhe dokumentet e autoritetit kontraktues, dokumentet relevante lidhur me aktivitetin e prokurimit si dhe të gjitha provat që janë propozuar nga palët procedurale.

Duke u mbështetur te neni 111 paragrafi 5 lidhur me nenet 113 dhe 114 të LPP, Paneli Shqyrtues me datë ka autorizuar ekspertin shqyrtues për të bërë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve sipas ankesës me nr. 0179/2026 dhe 0180/2026 i cili është dorëzuar me datë 08.04.2026, me Rekomandimin se refuzohet ankesa dhe mbetet në fuqi vendimi i AK-se.

Rekomandimi i ekspertit shqyrtues; Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues refuzohet si e pabazuar dhe të mbetet në fuqi vendimi i AK.

*Lidhur me pretendimet e OE ALL STONE SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0179 ka vlerësuar si në vijim:*

Pretendimi nr. 1

Pretendimi kryesor ankimor sipas ankesës 179/26 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK, ku sipas AK-së i njëjti ka ofruar çmime dukshëm më të larta se çmimet e tregut.

OE ankues ndër të tjera pretendon se:

“Fillimisht, para se të paraqesim dëshmitë tona në lidhje me këto pozicione, ju njoftojmë se oferta jonë nuk mund të konsiderohet si ofertë jo-normalisht e ulët/lartë siç përcaktohet me Nenin 41.3 të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik dhe nuk dihet qëllimi i AK-së se pse ofertën tonë e ka konsideruar si të tillë.

a) Pozicioni A.2. Hapja e kanaleve me pajisje të rënda Eskavator të peshave të rënda minimum 25 ton. Në çmim duhet të llogaritet transporti i makinerisë deri në vendin ku do të kryhen punimet, pra makineria e cila bën hapjen e kanaleve llogaritet çmimi vetëm prej fillimit të kryerjes së punimeve. Çmimi i ofruar njësi: 285.00 €/orë.

Lidhur me pozicionin A.2, sqarojmë se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë, për të cilën nuk është i njohur paraprakisht lokacioni i punimeve, kohëzgjatja e ndërhyrjes apo distanca e transportit të makinerisë, çka paraqet rrezik ekonomik të drejtpërdrejtë për operatorin ekonomik. Në përshkrimin e pozicionit është përcaktuar qartë se në çmim duhet të përfshihet transporti i makinerisë deri në vendin e punimeve, ndërsa pagesa llogaritet vetëm nga fillimi i kryerjes së punimeve, pa u kompensuar koha dhe kostoja e transportit.

Eskavatorët me peshë minimale 25 ton kanë kosto të larta operative, duke përfshirë shpenzime të konsiderueshme të naftës (konsum i lartë për orë pune), servis të specializuar, amortizim të shpejtë të pajisjes si dhe kosto shtesë për transport me mjete të posaçme. Në praktikë, mund të kemi raste kur makineria transportohet në distanca deri në 80 km, ndërsa ndërhyrja në terren zgjat vetëm 1–2 orë, për çka operatori ekonomik paguhet vetëm për kohën e punës, p.sh. 570 € për 2 orë, ndonëse kostoja reale e shërbimit është dukshëm më e lartë.

Për më tepër, duhet pasur parasysh edhe rreziku që lidhet me lokacionin e zhvillimit të punimeve, përfshirë mundësinë e dëmtimit të pajisjes dhe rrethanat e paparashikueshme të sigurisë, të cilat paraqesin rrezik shtesë dhe mbesin përgjegjësi e operatorit ekonomik. Për këto arsye, çmimi i ofruar prej 285.00 €/orë është plotësisht i arsyetuar ekonomikisht, reflekton rrezikun, kostot reale dhe natyrën e kontratës kornizë dhe nuk mund të konsiderohet çmim jo-normalisht i lartë sipas legjislacionit në fuqi.”

OE ankues po ashtu, sa i përket pozicioneve tjera të kontestuara nga AK, potencon se:

“Lidhur me pozicionet B.1, B.2, B.3 dhe B.4, sqarojmë se të gjitha këto pozicione kanë të njëjtën natyrë shërbimi, përkatësisht mbajtjen në posedim të pajisjeve të rënda dhe jo përdorimin apo operimin aktiv të tyre. Në përshkrimin e secilit pozicion është përcaktuar qartë se çmimi llogaritet vetëm nga momenti i dorëzimit të makinerisë, ndërsa transporti, përgatitja teknike, mirëmbajtja, sigurimi dhe gatishmëria teknike mbesin barrë e operatorit ekonomik.

Mbajtja në posedim e pajisjeve të rënda (bulldozer min. 30 ton, mjete transportuese min. 35 ton dhe pajisje për ngarkim min. 25 ton) nënkupton kosto të vazhdueshme dhe të pashmangshme, duke përfshirë amortizimin e makinerisë, shpenzimet e mirëmbajtjes, sigurimin, personelin teknik në gatishmëri si dhe bllokimin e pajisjeve nga angazhime të tjera komerciale. Për më tepër, duke qenë se bëhet fjalë për kontratë publike kornizë, kohëzgjatja e mbajtjes në posedim nuk është e paracaktuar, çka rrit rrezikun ekonomik për operatorin ekonomik.”

AK, në refuzim të kërkesës për rishqyrtim, potencon se të njëjtit kanë kërkuar sqarime shtesë nga OE ankues, megjithatë sqarimet e ofruara nuk kanë qenë bindëse për AK-në. Në përgjigje, AK po ashtu ka ofruar një listë të pozicioneve të kontestuara, ku janë vendosur çmimet e parashikuara, nga ku del se çmimet e ofruara nga OE ankues janë nga 50% deri 100% se ajo që ka parashikuar AK. Kjo vlerësojmë se vë në rrezik mundësinë për realizim të mirë të kontratës pasi AK mund të shpenzojë të gjithë buxhetin e këtij aktiviteti pa arritur t'i plotësojë nevojat e AK-së në tërësi.

Në rastin konkret vlerësojmë se mbetet në diskrecion dhe në përgjegjësi të AK-së vlerësimi i çmimeve të kontestuara dhe rekomandojmë të mbetet në fuqi vendimi i AK-së.

Pretendimi nr. 2

Pretendimet nr. 2 dhe nr. 3 janë se përmes shkeljeve të AK-së (të cekura në pretendimin nr. 1) AK ka bërë shkelje të tjera të LPP-së dhe legjislacionit sekondar si neni 59 i LPP-së si dhe nenit 40.13 të RrPP-së dhe Neni 97.1.o të RRPP-së.

Mendimi i ekspertit shqyrtues është se AK nuk ka bërë shkelje të dispozitave të lartcekura.

- Lidhur me pretendimet e OE Company Murseli SH.P.K., eksperti shqyrtues përmes raportit nr. 2026/0180 ka vlerësuar si në vijim:

## Pretendimi nr.1

Pretendimi kryesor ankimorë sipas ankesës 180/26 ka të bëjë me arsyen e eliminimit të OE ankues nga AK, ku sipas AK-së i njëjti per pajisjet që nuk janë në pronësi të OE, marrvëshjet per marrje me qera me kompani tjera nuk i ka noterizuara.

OE ankues pretnedon se edhe pse marrvëshjet nuk janë të noterizuara ato janë valide dhe duhet të pranohen si të të tilla.

OE ndër të tjera në ankesë potnecon se”

“Autoriteti kontraktues na ka kërkuar sqarime shtesë në lidhje me listën e marrëveshjeve për marrjen me qira të makinerive me dt.10.02.2026, ndërsa ne i kemi ofruar sqarimet në lidhje me kërkesën me sqarime me dt.13.02.2026, ku kemi sqaruar se marrëveshjet janë valide dhe të nënshkruara nga palët përkatëse përkatësisht qiradhënësi dhe qiramarrësi. Po ashtu e kemi inkuraju autoritetin kontraktues që nëse ka ndonjë dilemë në lidhje me këto makineri, që të dalin në terren dhe ti verifikojnë ato. Ne edhe pse i kemi ofruar sqarimet të cilat i ka kërkuar autoriteti kontraktues, përsëri jemi eliminuar me arsyetimin se marrëveshjet nuk janë ofruar të noterizuara. 4 me Sa i përket arsyes së eliminimit tonë, ne edhe një herë po e sqarojmë se marrëveshjet për qira të makinerive ne i kemi të nënshkruara me kompanitë përkatëse të ndryshme. Këto marrëveshje janë të nënshkruara vullnet të plotë të palëve, prandaj janë të plotfuqishme dhe nga origjinali i marrëveshjeve janë skenuar këto dokumente dhe janë bashkëngjit me ofertë”.

Eksperti shqyrtues jep mendim se kërkesa e dosjes së tenderit ka qenë e qartë, se marrëveshjet me kompani tjera DUHET të jenë të noterizuara, andaj pretendimi ankimorë sipas mendimit të ekspertit është i pabazuar.

- Gjetjet e Panelit Shqyrtues –

Rregullorja e Punës së Organit të Shqyrtimit Publik, e cila gjendet e publikuar në Webfaqen e OSHP-së, me nenin 20, paragrafi 2 të Rregullores, përcakton kërkesat për Autoritetin kontraktues dhe Operatorin ekonomik, që të gjitha informatat dhe njoftimet duhen të dorëzohen dhe komunikohen përmes platformës së komunikimit publik, nëse kjo është e mundur.

Bazuar në shkresat e kësaj lënde, Paneli konsideron se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, në kuptim të nenit 24 paragrafit 1 të Rregullores së Punës së OSHP, duke marrë parasysh faktin që pretendimet e palëve dhe parashtrirat e tyre, provat si dhe raporti i ekspertit shqyrtues ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritot.

Paneli shqyrtues vlerëson se Raporti i ekspertit shqyrtues, i hartuar me kërkesën e Panelit lidhur me kontestin në këtë lëndë të aktivitetit të prokurimit publik, përmban elementet qenësore të një dokumenti të tillë sikurse parashihet me dispozitën e nenit 113 lidhur me nenin 114 të LPP, sipas të cilit kërkohet nga eksperti që ta shqyrtojë gjithë dokumentacionin e prokurimit, përfshirë të gjitha pretendimet ankimore dhe të pajisë Panelin dhe të gjitha palët në konteste me një vlerësim të pavarur dhe profesional mbi aktivitetin e prokurimit dhe vlefshmërinë e pretendimeve ankimore.

Mirëpo duhet theksuar faktin ligjor se raporti i ekspertizës nuk është detyrues për Panelin shqyrtues dhe se çdo raport i tillë vlerësohet dhe/ose analizohet në kontekstin e përgjithshëm të

shkresave të lëndës, fakteve të pohuara dhe të provave eventuale e tjerë, duke e pasur parasysh natyrën e shkeljeve eventuale, rrjedhën, natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit, prandaj fakti se në cilat raste dhe për çfarë, Paneli e mbështetet apo jo, raportin e ekspertit dhe/ose ndonjë nga rekomandimet, i takon gjykimit të pavarur dhe profesional të tij/sajë, ashtu sikurse i adresohen këto përgjegjësi në kuptim të nenit 98, 99 lidhur me nenin 105 të Ligjit të Prokurimit Publik.

Sipas të thënave më sipër, eksperti shqyrtues i ka trajtuar në mënyrë profesionale dhe objektive të pretendimet e operatorve ekonomik ankues OE” ALL STONE “SH.P.K. dhe OE” Company Murseli “SH.P.K. Argumentimi në raportin e ekspertit shqyrtues është mjaft i detajuar, i kuptueshëm dhe i bazuar tërësisht dokumentet relevante që i referohen aktivitetit të prokurimit. Konstatimet në raportin e ekspertit shqyrtues mund të konfirmohen përmes dosjes së tenderit si dhe dokumenteve me të cilat ka kanë ofertuar tenderuesit. Raporti i ekspertit shqyrtues ka vlersuar se pretendimet e operatorve ekonomik ankues OE” ALL STONE “SH.P.K. dhe OE” Company Murseli “SH.P.K. , janë të pa bazuara.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën OE” ALL STONE “SH.P.K, vleron se në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik OE” ALL STONE “SH.P.K, duhet refuzohen si e pa bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, për anulimin e aktivitetit prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, dt.27.02.2026 lidhur me anulim të aktivitetit prokurimit “Marrja me Qera e Makinerive te Renda” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11613-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS.

Paneli shqyrtues lidhur me ankesën OE” Company Murseli “SH.P.K, vleron se në rastin konkret nga raporti i ekspertit shqyrtues, dëshmitë e prezantuara nga operatori ekonomik ankues, dokumentet e dosjes së tenderit si dhe nga provat tjera të rastit është gjetur se pretendimet ankimore janë të pa bazuara, të paraqitura ndaj Vendimit të autoritetit kontraktues për anulimin e aktivitetit prokurimit. Duke u bazuar në gjendjen faktike të konstatuar si më sipër, Paneli Shqyrtues i ka falur besimin e plotë konstatimit dhe rekomandimit në raportin e ekspertit shqyrtues. Paneli shqyrtues pas administrimit dhe vlerësimit të provave, konstatimit të plotë të gjendjes faktike, duke u mbështetur në LPP si ligj material të zbatueshëm, pas shqyrtimit të pretendimeve ankimore, duke marrë parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe rekomandimet e ekspertit shqyrtues, ka gjetur se ankesa e Operatorit ekonomik OE” Company Murseli “SH.P.K,duhet refuzohen si e pa bazuar dhe mbet në fuqi Vendimi i autoritetit kontraktues, për anulimin e aktivitetit prokurimit. Rrjedhimisht Paneli Shqyrtues ka vendosur për të vërtetuar, Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues, dt.27.02.2026 lidhur me anulim të aktivitetit prokurimit “Marrja me Qera e Makinerive te Renda” me nr. të prokurimit: "214/30400-25-11613-2-2-1", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – POLICIA E KOSOVËS

Prandaj duke ju referuar nenit 104.1, të LPP, sipas të cilit kërkohet që procedura e shqyrtimit të zbatohet në mënyrë të shpejt, të ligjshme dhe efektive dhe duke i analizuar po ashtu në tërësinë e tyre shkresat e kësaj lënde në kontekstin e këtij procesi të prokurimit, Paneli nuk e konsideroi të nevojshme ta shtjelloj sërish në detaje dhe pa nevojë në këtë rast secilin pretendim ankimor, përderisa të njëjtat në mënyrë specifike janë veçuar sidomos në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe janë analizuar dhe argumentuar pa vërejtje nga ana e këtij Paneli. Krahas tjerash, në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues dhe në raportet e ekspertit shqyrtues janë dhënë shpjegime të drejta po ashtu edhe lidhur me pohimet ankimore. Paneli vëren se arsyet e dhëna në vendimin e atakuar të autoritetit kontraktues janë profesionale dhe të argumentuara pa vërejtje me prova materiale, pa nevojë që të përshkruhen sërish. Prandaj Paneli mbështet vlersimet e ekspertit shqyrtues me rekomandim, të cilët kanë shpjeguar në raportin e ekspertizës së tij me numër; 2026/0179 dhe 2026/0180, se gjatë zhvillimit të kësaj procedurë të prokurimit, autoriteti kontraktues ka zbatuar dispozitat ligjore të LPP-së.

Paneli shqyrtues thekson se konform nenit 1 dhe 6 të LPP, se Autoritetet kontraktuese ushtrojnë pavarësinë e tyre institucionale në procesin e prokurimit publik, mirëpo mbetet në kompetencat dhe përgjegjësitë e këtij organi shqyrtimi i pretendimeve ankimore dhe ligjshmërisë në procesin e prokurimit sipas nenit 24, paragrafi 2 i LPP cituar "Autoriteti kontraktues është përgjegjës për të siguruar që të gjitha aktivitetet e prokurimit të autoritetit të tillë kontraktues të ekzekutohen në përputhshmëri të plotë me këtë ligj" lidhur me nenin 59,1 cituar "Autoriteti kontraktues do të themeloj një Komision Vlerësues për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e ofertave. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës"

Paneli shqyrtues bazuar në faktin e refuzimit të ankese të OE" ALL STONE "SH.P.K dhe të OE" Company Murseli "SH.P.K. u konfiskohet tarifa e ankesës në shumën e deponuar nga operatorët ekonomik ankues bazuar në nenin 31 par. 5 të Rregullores së Punës së OSHP, ndërsa mjetet të kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Paneli Shqyrtues ka vendosur në përputhje me kompetencat ligjore në kuptim të nenit 104 paragrafi 1 lidhur me nenin 103, nenin 105 dhe nenin 117 të LPP për zbatimin e procedurës së shqyrtimit të prokurimit në mënyrë të shpejtë, të drejtë, pa diskriminim, me qëllim të zgjidhjes së ligjshme dhe efektive të lëndës. Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

**Isa Hasani**

*Hasani*

### **Këshillë juridike:**

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komeriale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të vendimit.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - POLICIA E KOSOVËS, POLICIA E KOSOVËS**
- **OE - ALL STONE SH.P.K., Company Murseli SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: